



Prishtinë, 30 qershor  
2009  
Kodi i ZRRE-së: V\_201\_2009

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në nenin 15, 26 dhe 36.4 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 1.4 dhe Kapitullit 10 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Nenin 13 të Licencës për gjenerim të energjisë elektrike (licenca numër ZRRE\_Li\_09\_06); dhe
4. Kërkesën e “Triangle General Contractors-INC” –dega në Kosovë (“TGC-INC”), të bërë me datë 23 shkurt 2009 për transferim të licencës për Gjenerim të energjisë elektrike, nga ndërmarrja “TGC-INC”, adresa: Sheshi “Mentor Tolaj” 87, në “KelKos Energy” SH.P.K (KelKos), adresa: Arbëria-Dragodan-Zagrebit 19-Top 22.
5. Aplikacionin e “KelKos Energy” SH.P.K për transferim të licencës, të bërë me datë 28.05.2009,

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2009 nxori këtë:**

### VENDIM

- I. **APROVOHET TRANSFERIMI** i licencës nga “TGC-INC” me numër të regjistrimit të licencës ZRRE\_Li\_09/06, te “KelKos Energy” SH.P.K, tani e tutje me numër të regjistrimit të transferimit të licencës ZRRE/ Tr 01/\_Li\_09/06.
- II. **Transferimi i licencës do të vlejë nga data 30 qershor 2009 deri më 29 prill 2024.**

### Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 23 shkurt 2009 ka pranuar nga ndërmarrja “TGC-INC”, kërkesën për transferim të licencës për Gjenerim të energjisë elektrike nga “TGC-INC” në “KelKos” Sh.P.K. ndërsa me datë 28.05.2009 ka pranuar aplikacionin e “KelKos Energy” SH.P.K për transferim të licencës.
2. Përveç dëshmive të përgjithshme të kërkuara me aplikacionin për transferim të licencës, aplikuesi ka bashkangjitur edhe dëshmitë specifike si në vijim:
  - Vendimin e Bordit të KEK Sh.A-së, të datës 06.03.2009 për miratimin e bartjes së të drejtave dhe obligimeve nga TGC INC në “KelKos”



- Deklaratën mbi miratimin e transferimit të Kontratës mbi Qiranë dhe Kontratën për Blerjen e Energjisë të lidhur me datë 09.03.2009 në mes të TGC INC-së, “KelKos”-it dhe KEK SH.A-së, me pajtimin e përfaqësuesit të MEF-it;
- Marrëveshjen për transferim, në mes të “TGC INC”-së dhe “KelKos”-it, të datës 03.03.2009;
- Strukturën e re të stafit të “HC Lumbardhi”;



- Deklaratën mbi betimin e bërë nga drejtori ekzekutiv i “KelKos”-it;
  - Strukturën pronësore të “KelKos”-it;
  - Certifikatën e regjistrimit të “KelKos”-it,
  - Marrëveshja e nënshkruar në mes të “KelKos”-it dhe “KOSTT”-it, me të cilën “KelKos”-i pranon kushtet e pagesës së tarifës për operim të sistemit dhe tregut.
3. Me datë 30 qershor 2009 Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të aplikacionit për transferim të licencës si dhe dëshmive të bashkangjitura aplikacionit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.
4. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### Bordi i ZRRE-së

---

Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar